

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - departamenti i përgjithshëm divizioni penal si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtari individual Mustaf Tahiri dhe sek. juridike, Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.SH.H. nga fshati komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale vjedhja pylli nga neni 358 par.2 KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP nr.2910-3/14 të dt.21.09.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.24.03.2017 në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit Veton Shabani, si dhe të akuzuarit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi ndërsa me datë 18.04.2017 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

R.SH.H., nga fshati komuna Ferizaj, data e lindejs....., nga i ati Sh. dhe e ëma N., e gjinisë J, i martuar, prind i katër fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. Personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datën 05.12.2014, rreth orës 16.38, në pyllin publik, në vendin e quajtur, "Lugu i Dardhës", në rajonin ekonomik pyjor Neredime-Jezerc, pandehuri me qëllim vjedhje, është takuar duke prerë dy copë dru ahu të njomë, me diametër 58-60 cm, me gjatësi prej 29 metra, e më vëllim të përgjithshëm prej 7.81 metra kub, drunjët kanë qenë të prerë me sharrë motorike dhe e ka bartur me traktor IMT-533, duke i shkaktuar Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dëm material në vlerë prej 1054.35€ ,

me të cilën kreu veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 21, 41,42, 43,45, 46, 48 dhe 73 të KPK-së, dhe nen 365 të KPPK-së, të akuzuarin e,

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBË në lartësi prej 200 € (njëqind euro) si dhe **DËNIM BURGIMI** në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj.

Në mbështetje të nenit 46 par.5 dhe nenit 48 par.1 të KPK-së, dënimi i shqiptuar me gjobë dhe dënimi me burgim me pëlqimin e të dënuarit i zëvendësohet :

ME PUNË NË DOBI TË PËRGJITHSHME prej 160 (njëqind e gjashtëdhjetë) orëve, të cilën do ta kryej pa pagesë në afat prej tre muajve prej ditës së fillimit të ekzekutimit.

Konform nenit 48 par. 2 të KPK-së, Shërbimi Sprovues i Kosovës cakton llojin e punës që duhet të kryej personi i dënuar, cakton organizatën në të cilën duhet të punoj i dënuari, cakton ditët, javët që i dënuari duhet të kryej punë në dobi të përgjithshme, si dhe të mbikëqyrë e punën në dobi të përgjithshme.

Në mbështetje të nenit 46 par. 5 të KPRK-së nëse pas kalimit të kohës së caktuar i pandehuri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht, gjykata do të urdhëroj dënimin me gjobë ku për çdo 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë, e nëse dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet as në mënyra të tjera të parapara në nen. 46 par.3 të KPK-së, do të ekzekutohet në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € i pandehuri do të vuaj një ditë burgu.

Ndërsa në mbështetje të nenit 48 par.4 të KPK-së, nëse pas kalimit të kohës së caktuar i pandehuri nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht, gjykata do të urdhëroj dënimin me burgim, ku një ditë burgim do të urdhërohet për çdo (8) tetë orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës DPBZHR në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin në vlerë prej 1054.35 €, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqësor shumë prej 30 €, në afat prej 30 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP nr.2910-3/14 të dt.21.09.2015 e ka ngarkuar të pandehurin R.SH.H. nga fshati komuna Ferizaj, për veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.2 të KPK.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale me date 24.03.2017 mbajti shqyrtimin gjyqësor, në të cilën përfaqësuesi i akuzës – prokurori i shtetit Veton Shabani fillimisht lexoi aktin akuzues dhe më pas para fjalës përfundimtare ka bërë përmirësimin e dispozitivit të aktakuzës ashtu që në reshtin e pestë ku është shkruar traktor Rahovic përmirësohet dhe duhet të jetë Traktor IMT 533 dhe pjesa tjetër e dispozitivit mbetet e pa, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka mbet në tërësi pranë akuzës dhe kualifikimit juridik të saj, njëherit ka kërkuar nga gjykata të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptoj dënim të paraparë me ligj.

Gjyqtari individual pasi u bind se i pandehuri ka kuptuar akuzën, konform nenit 325 të KPPK-së të akuzuarit i ofroi mundësin të pranoj fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri R.SH.H. në shqyrtimin gjyqësor është deklaruar i pa fajshëm për veprën penale me të cilën është ngarkuar..

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, ku në bazë të këtij vlerësimi vërtetohet gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike gjykata e vërtetoi nga dëshmia e dëshmitarit A.A. roje pylli, i cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se lidhur me këtë çështje penale ka përpiluar një raport dhe fletëparaqitje me nr.të ditarit 062/14 të datës 05.12.2014 dhe në bazë kësaj edhe e kam paraqitur në këtë raportin me shkrim në ora 16.38 në vendin e quajtur Lugu i Dardhës në fshatin Jezerc e ka takuar R.SH.H. pasi që të njëjtin e njoh edhe me herët të njëjtin e ka njohur dhe është personi i cili është në këtë sallë si i pandehur. Në momentin kur e ka takuar të pandehurin i njëjti ka qenë me traktorin IMT 533 me rimorkio dhe i njëjti ka pasur motor sharë ku i kishte prerë dy lisa të njomë ahu me diametër 60-58 cm, pastaj i kishte këto dru dëshmitari i kishte bërë matjen e drunjtëve ku prezent ka qenë edhe i pandehuri dhe se i njëjti ishte sjellë mirë dhe nuk e ka kundërshtuar as matjen e drunjtëve e as përpilimin e raportit në prezencën e tij.

Gjykata dëshminë e këtij dëshmitari e vlerësoj si të besueshme, reale dhe objektive, pasi që e njëjta është e mbështetur në prova dhe fakte të cilat janë administruar në cilësinë e provës siç është fletëparaqitjet e Rojës së Pyjeve me nr.4463/14, procesverbali i Drejtorisë për Bujqësi e pylltari nr. 463/14 i dt.12.12.2014, raporti i rojës së pyllit nr.463/14 i dt.10.12.2014 si dhe në dokumentacionin tjetër që gjendet në shkresat e lëndës.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësorë nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ka ngarkuar akuza duke deklaruar se është e vërtet se me datën 05.12.2014 ka qenë në mal së bashku me dy fëmijët e tij dhe ka qenë me traktor IMT 533 dhe se e ka parë rojën e pyllit larg nga shpati, mirëpo roja e pyllit nuk është ofruar tek ai për të biseduar. I pandehuri ka deklaruar se atë ditë ka qenë në mal duke marrë drunjë të thata dhe se nuk ka prerë drunjë të njoma por drunjë të thata dhe se nuk pasë sharë motorike me vete duke deklaruar se traktorin e ka pasur të ngarkuar me drunjë të thata.

Mbrojtja e të pandehurit se nuk e ka kryer veprën është pabazuar nuk ka mbështetje në prova dhe fakte, dhe si e tillë më shumë e orientuar në drejtim të justifikimit të veprimeve të tij inkriminuse, me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale dhe është shumë e qartë se i pandehuri dëshiron t'i shmangët përgjegjësisë penale. Pra gjykata në bazë të gjitha provave të rastit dhe në bazë të deklarimeve të dëshmitarit ka vërtetuar gjendjen e fakteve si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, dhe se vlerësuar nga

aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale vjedhja e pyllit në vazhdim nga nen. 358 par.2 të KPRK –së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit nenit 73 të KPPK-së, si rrethana lehtësuese gjykata mori gjendjen e varfër të pandehurit, i pa punë, si dhe rrethanat e tij familjare, i njëjti është i martuar, prind i katër fëmijëve ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti. Në bazë të këtyre rrethanave gjykata i caktoj dënim si në dispozitiv të aktgjykimit, duke qenë e bindur se një dënim i tillë është plotësisht i justifikueshëm dhe në proporcion me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetit e të pandehurit, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i pandehuri në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të përgjithshëm të kësaj vepre penale në shoqëri.

Gjykata konform nenit 463 par.2 të KPPK-së vendosi në tërësi lidhur me kërkesën pasuroro-juridike, andaj të pandehurin e ka obliguar që të dëmtuarës DPPZHR zyra në Ferizaj t’ia kompensoj dëmin në vlerë prej 1054.35 €, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ngase provat e mbledhura në procedurë penale paraqesin bazë të sigurt për gjykimin e plotë të kësaj kërkesë, dhe atë bazuar në procesverbalin nr.463/2014 të datës 12.12.2014 dhe procesverbalin nr.463/2014 të datës 12.12.2014 me të cilin është llogaritur dëmi i shkaktuar të dëmtuarës.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë konform nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, dhe Gjykata e ka obliguar të pandehurin që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 €, në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e cekura më lartë është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- departamenti i përgjithshëm divizioni
penal**

P.nr.1115/15 të dt. 18.04.2017

Sek.juridike
Drita Ujupi

Gj y q t a r i
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE – kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj gjykate.